



REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. 3239/Prot.

Kavajë, më 19.06.2024

Lënda: Kthim përgjigje

**Komisionerit për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**
Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ndërtesa 5, Tiranë

Qendra "Res Publica"
Përfaqësuar nga Z.Dorian Matlija
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Në vijim të shkresave tuaja, respektivisht: shkresës me nr.1454/1 Prot., datë 10.06.2024, protokolluar pranë Bashkisë me Nr.3239 Prot. hyrës, datë 12.06.2024, me lëndë: "Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe kërkesës nr.81/24, datë 07.05.2024 të Qendrës "Res Publica", drejtuar Bashkisë Kavajë, së bashku me email të datës 07.05.2024 që vërteton dërgimin e shkresës së mësipërme, pas ankimit administrativ me shkresën me nr.1454 prot., datë 05.06.2024, që ka bërë kjo qendër, në lidhje me mosvënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit në lidhje me pallatin, me vendndodhje në Golem, rruga "E Detit", pranë rrethrotullimit, ju bëjmë me dije se:

-Koordinatori për të drejtën e informimit, Z.Genti Lushka, me adresë elektornike: genti.lushka@bashkiakavaje.gov.al, adresë në të cilën ju keni dërguar kërkesën për vënie në dispozicion të dokumentacionit dhe informacionit sa më sipër kërkuar, është larguar nga detyra me urdhër të Kryetarit të Bashkisë që në datën 30.10.2023.

Kjo është dhe arsyeja e moskthimit të përgjigjes nga ana jonë brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Sa më sipër, ju informojmë për adresën e email: info@bashkiakavaje.gov.al në lidhje me çdo kërkesë, për të qënë sa më transparent në lidhje me dhënieve të informacioneve apo dokumentacioneve të kërkuara nga ana juaj.

Bashkëngjitur kësaj shkrese ju vëmë në dispozicion aktet e kërkuara nga ana juaj si më poshtë:

-Kontratë për realizimin e punimeve të ndërtimit, me objekt: "Riforcimi i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar me shkallë dëmtueshmërie DS4, qyteti Kavajë", së bashku me aktet bashkangjitur, fotokopje të njehsuar me origjinalin e ndodhur në dosjen e procedurës në Zyrën e Prokurimeve Publike në Bashkinë Kavajë, gjithsej 1-58 fletë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KRYETARI
FISNIK QOSJA
Në mungesë dhe me ordhër
Sekretar i Përgjithshëm
ARTI ÇIÇOLLI

